

N. Frashëri – Fjalët e qiririt

-Pyetje me shtjellim-

-shënime-

Cili është misioni i poetit dhe si e arrin përmbushjen e tij, sipas vargjeve:

*Në mest tuaj kam qëndruar
E jam duke përvëluar,
Që t'u ap pakëzë dritë,
Natënë t'ua bënj ditë.*

Në ç'kuptim janë përdorur nata dhe dita në vargun *Natënë t'ua bënj ditë*?

Argumento mendimin se ndriçimi i qiririt, ashtu si nata e dita, është përdorur në kuptimin alegorik, duke u mbështetur edhe në vargjet:

*Që t'u ndrinj mir' e të shihni,
Njëri-tjatrën të njihni.*

Me ç'mjete stilistike e ka theksuar poeti idenë e sakrifikimit në vargjet:

*Do të tretim, të kullohem,
Të digjem, të përvëlohem.*

Çfarë e detyron poetin të vetësakrifikohet?

*Për ju do të rri të tretim,
As një çikë të mos mbetem,
Të digjem e të qanj me lot,
Se dëshirën s'e duronj dot.*

Si bëhet nga ana pamore lidhja mes poetit-njeri dhe simbolit-qiri në vargjet:

*Për ju do të rri të tretim,
As një çikë të mos mbetem,
Të digjem e të qanj me lot,
Se dëshirën s'e duronj dot*

-shënime-

Argumentoni lidhjen që kanë midis tyre fjalët tretur, vdekur, jetë (gjallë), dritë.

*Kur më shihni që jam tretur,
Mos pandehni se kam vdekur,
Jam i gjall' e jam ndë jetë,
Jam në dritë të vërtetë.*

A mbaron jeta e poetit aty ku mbaron jeta e tij njerëzore?

-Ç'mbetet nga poeti përfundimisht?

*Kur më shihni që jam tretur,
Mos pandehni se kam vdekur,
Jam në dritë të vërtetë.
Unë jam në shpirtin tuaj,*

A e kundërshtojnë njëri-tjetrin vargjet e nënvizuara?

*Për ju do të rri të tretem,
As një çikë të mos mbetem,
Unë zjarit nuk' i ndruhem
Dhe kurrë s'dua të shuhem.*

Gjeni pjesën didaktike të kësaj poezie dhe komentojeni atë.

Ç'është Zoti i vërtetë, sipas kësaj poezie dhe cila është rruga për të shkuar tek ai?

Ç'kuptoni nga vargu

Kam qënë mik me njerinë?

-shënime-

Cili është kuptimi i vargjeve:

*Gjithë tuajt i kam parë,
Mëm' e at' e fis e farë,
Si tani gjith' i kam ndër mënt,
Që rrininë më këtë vënt.*

*Me zjar ta djek mushkërinë
E të tretem për njerinë
Bashkë me gëzimt të tija
Të vete te Perëndia.*

Ndërkohë që poeti ka thënë: *Të digjem i tëri*, tani thotë:
Me zjar ta djek mushkërinë.

Pse pikërisht mushkërinë?**Çfarë është poezia, sipas vargjeve të fundit?**

*Dhe unë si ju jam ndruar,
E jam përzjer' e ndryshuar,
Pa jam bërë shumë herë
Zjar e uj' e balt' e erë.*

Çfarë fsheh enumeracioni i vargut të fundit?**Cila është prejardhja e poezisë, sipas këtyre vargjeve?**

*Jam një shkëndijë pej qjelli,
Dhe një drudhezë prej djelli*

-Pse ka frikë mos i ngatërrojë njerëzit me fjalën e tij?**-Cili është tipari thelbësor i fjalës poetike?**

*Shumë fjalë dua t'u them,
Po trembem mos u bëj ujëm.
Po ku shkruhenë në kartë
Fjalët e gjuhës së zjartë.*